

Kriteret e Pranimi për Shkollat e Mesme me Pranim Special

Shkollat mund të vendosin të ndryshojnë kriteret e tyre të pranimit. Në rast mospërputhjeje në mes këtij dokumenti dhe politikës aktuale të shkollës, versioni i shkollës do të mbizotërojë.



[Harta e shkollave tetëvjeçare me pranim special](#)

Akademia për Nxënësit e Tetëvjeçares (AMY) Northwest (Klasat 6-8)

6000 Ridge Ave.

Philadelphia, PA 19128

[\(Harta!\)](#)

- A & B; jo më shumë se dy C, në dy vitet e mëparëshme
Nxënësit e vlerësuar në, ose mbi 70% të Testit të PSSA në Lexim dhe Matematikë (mund të merren në konsideratë edhe teste të tjerë të njohura në shkallë kombëtare.)
[\(Tabela e Konvertimit të PSSA\)](#)
- Nxënësit me frekuentim të lartë – jo më shumë se 7 mungesa, ose 5 raste vonesash gjatë vitit shkollor paraardhës
- Nxënësit që manifestojnë sjellje të mirë; që nuk kanë histori të incidenteve serioze, ose të pezullimeve (Prindërve do t’u kërkohet të firmosin një marrëveshje për sjelljen, e cila do të theksojë angazhimin e tyre për përmbushjen e kodit të sjelljes së nxënësit. Në rast se fëmija i tyre nuk do të sillet mire, nxënësi mund të humbasë pranimin në “AMY NW” dhe do të kthehet ne shkollën e lagjes).
- Nxënësit, prindërit/kujdestarët e të cilëve angazhohen të marrin pjesë në së paku një aktivitet vullnetar gjatë vitit shkollor.

Ekipi i pranimit të shkollës shikon dhe vendos për të gjitha pranimet. Ju lutemi mbani në vëmendje faktin, që jo të gjithë aplikuesit e kualifikuar mund të pranohen për shkak të vendeve të mundëshme.

Andrew Hamilton Achieving in Middle School (AIMS) Magnet Program (Klasat 6-8)

5640 Spruce St.

Philadelphia, PA 19139

[\(Harta!\)](#)

Niveli i arritjeve në PSSA i avancuar ose i aftë (advanced or proficient)

- Notat e deftesës për dy vitet e fundit të jenë të gjitha “A dhe B”
- Shkalla e frekuentimit 90% , ose më mirë dhe një numër minimal vonesash
- Nota në sjellje duhet të jetë shkëlqyeshëm

Programi i Shkollës 8-vjeçare në Inxhinieri & Shkencë (Klasat 7-8)

1600 West Norris Street

Philadelphia, PA 19121

[\(Harta!\)](#)

- Notat - në lëndet kryesore A dhe B
- Frekuentimi – Mungesa dhe vonesa minimale
- Sjellja – Në deftesa të mos ketë pezullime ose komente negative per sjelljen
- Testi i Standardizuar - 80% dhe më lart në përqindjen e testit të fundit.
([Tabela e Konvertimit të PSSA](#))
- Ese – Një ese e shtypur në një faqe e cila spjeron arsyet tuaja pse doni të shkolloheni në Carver E&S

Conwell Middle Magnet School (Klasat 5-8)

1849 E. Clearfield St.

Philadelphia, PA 19134

[\(Harta!\)](#)

Nxënësit fillojnë në klasën e 5-të; do të ketë pranime të kufizuara në klasat 6-të, 7-të dhe 8-të.

- Minimumet e vlerësimeve në testin e standardizuar në Lexim dhe Matematikë për t'u kualifikuar për pranim, janë si më poshtë ([Tabela e Konvertimit të PSSA](#)):
Klasa 6 – në 70%
Klasat 7-të & 8-të – në 80%
- Nota të shkëlqyera, të gjitha “A” dhe “B” në deftesat për dy vitet e mëparshme
- Sjellje të Shkëlqyer në dy vitet e fundit me të gjitha komentet pozitive, të mos ketë pezullime gjatë vitit të fundit shkollor.
- Shkalla e frekuentimit të jetë 95% , ose më mirë, me një numër minimal vonesash
- Aplikuesit duhet të ndjekin një seminar testimi dhe interviste në shkollën Conwell. Njoftimi për këtë seminar do të ofrohet nga shkolla aktuale e nxënësit. Nxënësi që do të intervistohet duhet të shoqërohet nga prindi/kujdestari.

Girard Academic Music Program (GAMP) (Klasat 5-8)

2136 W. Rimer St.

Philadelphia, PA 19145

[\(Harta!\)](#)

- Kërkesat Mësimore:
 - 80% në PSSA, ose në testin e Standardizuar ([Tabela e Konvertimit të PSSA](#))
Notat në Dëftesë – A dhe B
 - Frekuentimi
 - Sjellja

- Kërkesat për Auditim:
 - Vokali –**Të gjithë** nxënësit do të provohen për vokalin muzikor, sepse të gjithë nxënësit do të marrin pjesë në korin e shkollës
 - Instrumentale – Nxënësit që kanë luajtur në një instrument muzikor për më shumë se një vit, nxiten të auditohen me instrumentin e tyre. Nxënësit kërkohet që të sjellin në auditim një pjesë të përgatitur për t’u performuar

Grover Washington Music Magnet Program (Klasat 5-8)

201 E. Olney Ave.

Philadelphia, PA 19120

[\(Harta!\)](#)

Do të publikohet

Hill-Freedman World Academy (Klasat 6-8)

1100 E. Mt. Pleasant Ave.

Philadelphia, PA 19150

[\(Harta!\)](#)

- Niveli i arritjeve në PSSA i avancuar ose i aftë (advanced or proficient)
- Nota të shkëlqyera të gjitha “A” dhe “B” në deftesat për dy vitet e mëparshme

Masterman Laboratory and Demonstration Middle Magnet School (Klasat 5-8)

1699 Spring Garden St.

Philadelphia, PA 19130

[\(Harta!\)](#)

- Minimalisht nxënësit e vlerësuar në 88% të Testit të PSSA në Lexim dhe Matematikë . Notat e shumicës të nxënësve të pranuar janë më të larta. ([Tabela e Konvertimit të PSSA](#))
- Familjet e shkollave jo publike duhet të kontaktojnë shkollën aktuale për informacionin e konvertimit të notave. Kur është e mundur do të merren në konsideratë edhe vlerësimet e testeve të njohura kombëtarisht. Nxënësit e shkollave të ndryshme duhet të dërgojnë arritjet në ERB, ose të testeve të tjera standarde të njohura
- Mund të pranohen nota më të ulta në lexim, për nxënësit që kanë jetuar më pak se tre vjet në U.S.
- Notat minimale për aplikim janë vetëm A dhe B. Shumica e nxënësve që janë pranuar i kanë pothuaj të gjitha notat A. Gjithashtu pranohen në aplikim edhe nivelet më të larta nga sistemet e tjera të vlerësimit të dijeve
- Përpara fillimit të klasës të nëntë, kërkohet një vit i plotë në Algjebër, si edhe në Frëngjisht, ose Spanjisht.
- Notat në sjellje/edukatë qytetare në të gjitha fushat duhet të jenë B ose më lart
- Kërkohet frekuentim dhe përpikëri e shkëlqyer